

Viti 2022

—


Botim V^{të}

KRESTON ALBANIA

—

www.kreston.al

RAPORTI I TRANSPARENCËS



knowing you



Përmbajtje

Hyrje

1. Struktura ligjore dhe pronësia e Shoqërisë
2. Kreston International Limited (Kreston Global)
3. Rotacioni i audituesve ligjorë
4. Struktura drejtuese e Shoqërisë
5. Sistemi i kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë
6. Rishikimi i pavarur i cilësisë dhe sigurisë
7. Auditimi i Njësive me Interes Publik nga Shoqëria gjatë vitit 2022
8. Deklaratat e praktikave të pavarësisë së Shoqërisë
9. Deklarata mbi politikën e ndjekur nga Shoqëria lidhur me edukimin e vazhdueshëm të audituesve ligjorë
10. Performanca financiare e Shoqërisë
11. Shtojca 1 - Njësi me Interes Publik

Emri i kompanisë:

KRESTON ALBANIA sh.p.k

Adresa:

Rruga "Muhamet Gjollesha",
Godina Qendra Tregtare Ring,
Shkalla 2, Kati 6, Ap. 6,
Tiranë, Shqipëri



Knowing



Hyrje

Shoqëria Kreston Albania sh.p.k ("Kreston Albania") me NIPT L42007012I, themeluar më datë 07.08.2014, është e regjistruar në Regjistrin Publik të IEKA-s me vendimin Nr. 430 datë 17.10.2014 të Autoritetit të Regjistrimit. Kreston Albania ofron shërbime të auditimit dhe të dhënies së sigurisë, shërbime të kontabilitetit dhe taksave, si dhe shërbime ligjore dhe të këshillimit financiar.

Si një firmë auditimi, e cila kryen auditimin ligjor të llogarive vjetore të njësive me interes publik, Kreston Albania sh.p.k ("Shoqëria") po publikon raportin vjetor të transparencës në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*" lidhur me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara vjetore.

you

I gjithë informacioni i dhënë në këtë raport lidhet me situatën e Shoqërisë Kreston Albania sh.p.k gjatë vitit 2022.



1. Struktura ligjore dhe pronësia e Shoqërisë

Shoqëria funksionon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Mbjtësit e kuotave të Kreston Albania sh.p.k janë:



- | | |
|--------------------------|-----|
| • Rezar Llucaçej | 26% |
| • Nuriona Sokoli Bërdica | 25% |
| • Triple A Holding | 49% |

2. Kreston International Limited (Kreston Global)

Kreston Albania i referohet një prej firmave anëtare të Kreston Global, e cila është një kompani private britanike me përgjegjësi të kufizuar nga garantorët. Secila nga firmat anëtare të rrjetit Kreston Global përfaqëson një entitet të pavarur ligjërisht dhe financiarisht. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të kompanisë Kreston Global dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën: www.kreston.com

Kreston Global ofron shërbime në fushat e auditimit dhe dhënies së sigurisë, kontabilitetit dhe taksave, si dhe të këshillimit financiar, për entitete si private ashtu dhe publike, të cilat operojnë në të gjitha industritë. Me anë të rrjetit botëror të 160 firmave anëtare në 115 shtete me më tepër se 23,500 profesionistë, Kreston Global sjell ekspertizën e secilit vend nën një perspektivë globale.

Kjo mundëson dhënien e këshillimit të duhur në kohë reale për mundësitë dhe sfidat në vende specifike, duke ofruar zgjidhje qoftë duke implementuar legjislacionin vendas ashtu edhe në kulturën e të bërit biznes. Orientimi proaktiv dhe i mirëmenduar i ofruar nga ekipi i dedikuar global, u mundëson bizneseve të pajisen me të gjitha njohuritë që u nevojiten për të arritur synimet e tyre. Profesionistët e afiluar me Kreston Global janë të angazhuar për të përcjellë shërbime me standard të lartë profesionalizmi.



Kreston Albania në Shqipëri

Shoqëria Kreston Albania sh.p.k është pjesë e rrjetit ndërkombëtar Kreston Global prej muajit dhjetor 2014. Shërbimet e auditimit ofrohen nga zyra e vetme në vend, e cila ndodhet në Tiranë dhe ofron shërbime të një cilësie të standardit të lartë.

3. Struktura drejtuese e Shoqërisë

Shoqëria drejtohet nga administratori Z. Rezar Lukaçej. Z. Lukaçej vepron si administrator i Shoqërisë sipas statutit të Shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".

Gjithashtu pjesë e drejtimit të Shoqërisë është Znj. Nuriona Sokoli Bërdica, e cila vepron si partnere e Shoqërisë në departamentin e auditimit në rolin "Audituese dhe Këshilluese" sipas statutit të Shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".



4. Rotacioni i audituesve ligjor

Në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 *"Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar"*, Shoqëria konfirmon se respektohet afati prej 7 vitesh nga data e caktimit si auditues ligjor për kryerjen e auditimit, duke realizuar rotacionin e audituesve ligjorë.

5. Sistemi i kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë

Shoqëria funksionon mbështetur në politika dhe procedura që promovojnë një kulturë të brendshme të bazuar në njohjen e faktit se cilësia është thelbësore në planifikimin dhe kryerjen e angazhimit. Kjo përcaktohet në Manualin e Politikave dhe Procedurave të Shoqërisë, i cili qëndron në themel të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë. Ky sistem përfshin politika dhe procedura që adresojnë përgjegjësitë e udhëheqjes për: sistemin e kontrollit të cilësisë brenda Shoqërisë, kërkesat etike, pranimin e klientit, anganzhimin dhe vazhdimësinë, burimet njerëzore, performancën e angazhimit dhe monitorimin.

Ky sistem i kontrollit të brendshëm të cilësisë përmban dy sisteme monitorimi:

- Rishikim i cilësisë në nivel angazhimi
- Rishikim i cilësisë në nivel firme

Rishikim i cilësisë në nivel angazhimi

Raportet e auditimit ligjor mbi pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara në lidhje me një njësi me interes publik, ndër të tjera, para lëshimit i nënshtrohen një rishikimi të angazhimit të cilësisë dhe sigurisë nga njëri nga partnerët e Shoqërisë, i cili ka përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme profesionale sipas angazhimit dhe industrisë përkatëse.

Rishikimi cilësisë në nivel angazhimi përfshin një rishikim të raportit dhe pasqyrave financiare ose informacioneve të tjera financiare pjesë e raportit, rishikim të memorandumit



të planifikimit të auditimit, ose të ekuivalentit, rishikim të memorandumit të përmbledhjes së auditimit ose ekuivalentit, apo rishikim i dokumentave të përzgjedhura të punës dhe dokumentacionet e tjera që konsiderohen të përshtatshme si letra e angazhimit. Gjithashtu, ky rishikim përfshin një diskutim me partnerin e angazhimit të auditimit në lidhje me çështje të rëndësishme që dalin gjatë angazhimit ose rishikimit. Nëse rreziku i angazhimit është vlerësuar si më i madh se normal, është i nevojshëm një rishikim më i gjerë, përfshirë një rishikim të dokumentacionit të përshtatshëm të punës që fokusohet në rreziqet e identifikuar dhe gjetjet përkatëse. Raporti i auditimit mund të lëshohet vetëm nëse rishikuesi është i bindur që ekipi i angazhimit ka bërë gjykimet dhe ka arritur në përfundimet e duhura dhe angazhimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe rregulloret e tjera sipas rastit.

Rishikim i cilësisë në nivel firme

Rishikimi i cilësisë në nivel firme përfshin rishikimin e praktikës së auditimit dhe është projektuar për të vlerësuar performancën e partnerit të auditimit së paku një herë gjatë një periudhe tre vjeçare. Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare, përzgjidhet të paktën një angazhim për rishikim. Vëmendje i kushtohet edhe vlerësimit të performancës së menaxherëve, veçanërisht atyre që janë kandidatë për partnerë në një periudhë afatshkurtër.

Siç është përshkruar më lart, Shoqëria është pjesë e rrjetit Kreston Global, i cili çdo vit administron programet e veta të rishikimit të praktikës dhe harton programe të tilla për të mbuluar një sërë zyrash të rrjetit. Shoqëria është subjekt i një rishikimi praktike të paktën një herë në çdo pesë vite. Kreston Global ofron udhëzime dhe mbikqyrje në lidhje me planet dhe procedurat e rishikimit dhe Shoqëria është përgjegjëse për implementimin e rezultateve të raportit të rishikimit. Koordinimi dhe administrimi i përgjithshëm i programit të rishikimit është përgjegjësia e drejtorit të rishikimit të kompanisë, në bashkëpunim me drejtorin rajonal të rishikimit, kur është e zbatueshme.

Objektivat e rishikimit të praktikës janë si më poshtë:

- Të marrë siguri të arsyeshme lidhur me pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e Kreston Global, përsa i përket auditimit;
- Të vlerësojë efektivitetin operativ të menaxhimit të rrezikut dhe procedurat e kontrollit të cilësisë;
- Të vlerësojë zbatimin e standardeve profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- Të marrë siguri të arsyeshme se metodologjia e auditimit të Shoqërisë është zbatuar siç duhet;
- Të marrë siguri të arsyeshme se sistemi i kontrollit të cilësisë të Shoqërisë është projektuar në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme, që vepron në mënyrë efektive dhe në përputhje me praktikën.

Gjetjet dhe rekomandimet që rezultojnë nga rishikimet e praktikës paraqiten në një raport rishikimi të praktikës dhe letër të menaxhimit që i adresohet drejtimit të Shoqërisë. Qëllimi i letrës së menaxhimit është të ofrojë sugjerime për përmirësim në përgjigje të gjetjeve të vrojtuar. Shoqëria i trajton gjetjet në raportin e rishikimit të praktikës duke hartuar një plan të detajuar veprimi, duke përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren, personat përgjegjës dhe kohën për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në letrën e rishikimit të praktikës, kur është e zbatueshme.

Përveç kësaj, i komunikohen partnerit dhe personelit përgjegjës, mangësitë (nëse ka) të vëna në dukje si rezultat i rishikimit të praktikës dhe rekomandimet për masat e duhura korrigjuese. Gjithashtu Shoqëria mbi një bazë vjetore komunikon rezultatet e rishikimit të praktikës, konsideratën dhe vlerësimin e vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të cilësisë ndaj partnerëve dhe individëve të tjerë brenda Shoqërisë.

Deklarata e komitetit drejtues

Komiteti drejtues i Shoqërisë beson se sistemi i kontrollit të brendshëm, siç është përshkruar më sipër, është efektiv në dhënien e sigurisë së arsyeshme që Shoqëria dhe stafi i saj veprojnë në përputhje me standardet profesionale të zbatueshme, kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe që raportet e auditimit të lëshuara janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse.



6. Rishikimi i pavarur i cilësisë dhe sigurisë

Rishikimi më i fundit lidhur me kontrollin e cilësisë së firmës nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka qënë në lidhje me auditimet e pasqyrave financiare që mbyllen me 31 dhjetor 2017. Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka paraqitur raportin me gjetjet përkatëse, të cilat janë adresuar nga ana e Shoqërisë.

7. Auditimi i njësive me interes publik të audituara nga Shoqëria gjatë vitit të 2022 është paraqitur në Shtojcën 1

8. Deklarata e praktikave të pavarësisë të Shoqërisë

Shoqëria ka në zbatim politika dhe procedura të shkruara të pavarësisë, të cilat përfshijnë kryerjen e kontrolleve të caktuara të pajtueshmërisë me pavarësinë në baza vjetore.

- Çdo vit nënshkruhet një deklaratë individuale pavarësie nga partnerët dhe stafi. Përveç kësaj, konfirmime të ngjashme pavarësie merren nga të punësuarit e rinj dhe ata që lënë kompaninë;
- Partnerët konfirmojnë njohjen dhe zbatimin me rregullat e pavarësisë dhe;
- Gjatë pranimit të klientit dhe angazhimit përdoren procedura për të verifikuar që pavarësia nuk cënohet.



9. Deklarata mbi politikën e ndjekur nga Shoqëria lidhur me edukimin e vazhdueshëm të audituesve ligjorë

Për të garantuar mbrojtjen e interesit publik, Shoqëria duhet të demonstrojë në cdo rast aftësi profesionale, kompetencë dhe qëndrime e vlera etike të larta. Për këtë qëllim të gjithë audituesit e Shoqërisë azhurnojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre teknike dhe profesionale nëpërmjet trajnimeve të shumta që ofrohen nga vetë Shoqëria si dhe nga kurse apo trajnime që organizohen jashtë Shoqërisë nga organe profesionale të akredituara.

Edukimi i vazhdueshëm

Edukimi i vazhdueshëm është një politikë kryesore e Shoqërisë, pasi ky është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e njohurive, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Trajnimet e ofruara nga Kreston Global janë një pikënisje, ku përfshihen trajnime teknike (GAAP, GAAS, rregullat profesionale, taksa, IT, menaxhim, aftësitë e buta). I gjithë stafi merr pjesë në trajnimet mbi Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, legjislacionin fiskal dhe rregulloret tregtare të zbatueshme. Trajnimet vjetore të përditësimit të njohurive në fushën e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar janë të detyrueshme për të gjithë stafin profesional të auditimit.

Programi i edukimit të vazhdueshëm është i përbërë nga sesione trajnimi të organizuara nga Shoqëria si dhe trajnime të jashtme. Departamenti i Burimeve Njerëzore është i ngarkuar me monitorimin e trajnimve të kryera brenda Shoqërisë dhe atyre të ofruara nga insitucione te akredituara jashtë saj, të ndjekura nga secili auditues. Kualifikimi i vazhdueshëm është gjithashtu një faktor që merret në konsideratë për vlerësimin vjetor të stafit të auditimit dhe vlerësimin të potencialit të tyre të rritjes.



10. Performanca financiare e Shoqërisë

Më poshtë është evidentuar informacioni financiar i paaudituar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, i cili demonstroi rëndësinë e auditimit ligjor për performacën financiare të Shoqërisë.

Të ardhurat	LEK
Auditimi Ligjor i njësive me interes publik	26,071,297
Auditimi Ligjor i njësive me interes jo-publik	20,778,679
Shërbime të tjera ndaj kompanive që Shoqëria i auditon	1,074,230
Shërbime të tjera ndaj kompanive të tjera	14,817,510
Shërbime të tjera	871,722
Totali	63,613,438

Shtojca 1 - Auditimi i njësive me interes publik të audituara nga Shoqëria gjatë vitit të 2022

Emri	Për vitin e mbyllur më
3P Life Logistic sh.p.k (në proces)	31 Dhjetor 2021
Agrigose sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Agrokredit sh.a	31 Dhjetor 2021
Alumil Albania sh.p.k. për qëllime të grupit	30 Qershor 2022
Alumil Albania sh.p.k.	31 Dhjetor 2021
ARB-SECURITY GROUP sh.p.k	31 Dhjetor 2021
BUKA sh.a	31 Dhjetor 2021
CBF sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Das Oil sh.p.k	31 Dhjetor 2021
D&E sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Deloitte Albania sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Eroil sh.a	31 Dhjetor 2021
ESM sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a (në proces)	31 Dhjetor 2021
Helius Systems sh.p.k	31 Dhjetor 2021
IMC sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Interlogistic sh.p.k (në proces)	31 Dhjetor 2021
Klodioda sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Marketing & Distribution sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Marsi AL sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Medfau sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a (në proces)	31 Dhjetor 2021
Operatori u Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a (në proces)	31 Dhjetor 2021
Posta Shqiptare (në proces)	31 Dhjetor 2021
RAEA sh.p.k	31 Dhjetor 2021
SICPA Security Solutions Albania sh.p.k	31 Dhjetor 2021
Tobacco Holding Group sh.p.k.	31 Dhjetor 2021
TerraOil Swiss sh.a	31 Dhjetor 2021
TerraOil Swiss sh.a	31 Dhjetor 2020
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Shërbime të tjera
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Shërbime të tjera
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional	Shërbime të tjera



Emri i kompanisë:

KRESTON ALBANIA sh.p.k

Adresa:

Rruga "Muhamet Gjollesha",

Godina Qendra Tregtare Ring,

Shkalla 2, Kati 6, Ap. 6,

Tiranë, Shqipëri